

I nderuar Z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës suaj, bazuar në ligjin nr.119/2014, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”, dërguar institucionit të Kryeministrit, sipas së cilës kërkoni informacion në lidhje me ekzistencën e një *“urdhri/akti nënligjor që ndalon përdorimin publik të hapësirës së gjelbërt prapa Kryeministrit”* ju informojmë se kjo hapësirë nuk është në përgjegjësi administrimi të institucionit të Kryeministrit.

Gjithashtu, ju informojmë se në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 974, datë 2.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) e të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe në përdorim të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) e të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”” kjo hapësirë u ka kaluar këtyre institucioneve në përgjegjësi administrimi dhe në përdorim.

Ky vendim është publikuar në numrin 210 të Fletores Zyrtare, viti 2015 dhe mund të gjendet në faqen web:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/210-2015.pdf

Për çdo kërkesë të mëtejshme apo sqarim të nevojshëm, jeni të mirëpritur t’i paraqisni ato pranë institucionit të Kryeministrit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,